

RAPORT VJETOR 2025



“ATLANTIK” sh.a. - SHOQËRI SIGURIMESH



FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE!





SIGURIMI I BIZNESIT

FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE



atlantiksha



atlantik sh.a



Atlantik sh.a

I interesuar për siguracion?

t: +355 4 2 230 506

c: +355 68 206 8000

e: info@atlantik.com.al

PËRMBAJTJA

1. Informacioni rreth shoqërisë

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm.	5
Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë	7
Objektivat Kryesorë të Veprimtarisë së Biznesit që u orientuam për 2025	8
Struktura Organizative e Shoqërisë Atlantik Sh.a	9

2. Treguesit kryesorë të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2025

Informacion i përgjithshëm i tregut të sigurimeve	10
Treguesit kryesorë të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2025	11
Politika e pranimit dhe menaxhimit të rrezikut	12

3. Raporti i Audituesit të Pavarur

Misioni dhe funksioni	14
Metodologjia, baza ligjore dhe plani vjetor	14
Deklarata e Pavarësisë	15
Struktura organizative, raportimi dhe zhvillimi profesional	15

4. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2025

Opinion i Auditorit të Brendshëm	16
Objektivat strategjike për vitin 2025	16



SIGURIMI I SHËNDETIT NË UDHËTIM

FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE



atlantiksha



atlantik sh.a



Atlantik sh.a

I interesuar për siguracion?

t: +355 4 2 230 506

c: +355 68 206 8000

e: info@atlantik.com.al

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Miq të nderuar!

Vitet e fundit kanë konfirmuar se asnjë kompani nuk mund të qëndrojë e izoluar nga dinamika globale — politike, ekonomike dhe teknologjike. Gjatë 2025-ës, pasiguria e mjedisit ndërkombëtar vazhdoi të ndikojë në tregje, por stabilizimi i politikave monetare dhe përmirësimet graduale në furnizimet globale të energjisë krijuan një ambient më të favorshëm për rritje të qëndrueshme. Sektori i sigurimeve vazhdoi të përfitojë nga kapitalizimi i fortë, digjitalizimi i shërbimeve dhe përfitimet e transfertave digjitale.

Megjithatë, kryefjala e vitit të kaluar ishin ndryshimet klimatike.

2025 është konfirmuar zyrtarisht si viti i tretë më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë në histori, duke pasuar temperaturat ekstreme të viteve 2023 dhe 2024. Kjo u shoqërua me zjarre shkatërruese në pyje, por edhe me reshje rekord dhe stuhi e përmbytje që goditën edhe rajonin tonë.

U ndala jo pa qëllim te ndryshimet klimatike pasi lidhja mes tyre dhe tregut të sigurimeve po bëhet gjithnjë e më e ngushtë dhe sfiduese. Shqipëria konsiderohet si ndër më të rrezikuarit në rajon nga ngjarjet ekstreme të motit.

Përmbytjet e shpeshta që vitin e kaluar prekën zona të tëra të vendit dhe zjarret masive (sidomos në jug) kanë shtuar presionin mbi fondet buxhetore duke kthyer edhe një herë vëmendjen nga tregu i sigurimeve. Qeveria, në bashkëpunim me Bankën Botërore, kanë



Dritan ÇELAJ

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

hedhur për konsultim një projektligj për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga katastrofat natyrore, por kjo nuk mund të jetë zgjidhja e vetme.

Ajo që dua të theksoj është se Shqipëria duhet të fokusohet më shumë në rritjen e kulturës së sigurimit vullnetar të pronave të tyre nga ana e qytetarëve. Sigurimi i pronës nga zjarri, përmbytja apo tërmeti mbetet shumë i ulët. Pjesa më e madhe e policave për pronat (mbi 90%) blihen vetëm sepse kërkohen si kolateral nga bankat për marrjen e kredive. Sipas të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, rreth 90% e primeve të sigurimit nga katastrofat janë të përqendruara në Qarkun e Tiranës.

Raporti i AMF nënvizon se gjatë vitit 2025, tregu i sigurimeve në Shqipëri shënoi një

RAPORT VJETOR - 6

rritje prej 10%, krahasuar me një vit më parë. Primet e shkruara bruto kapën vlerën mbi 24.6 miliardë lekëve, por pjesa më e madhe e tyre erdhi gjithsesi nga sigurimet e detyrueshme motorike (TPL).

Veprimtaria e sigurimeve Jo-Jetë vijoi të mbetet segmenti dominues i tregut me 9.91% më shumë se në vitin 2024. Ndërsa, sigurimet e Jetës shënuan rritje më të lartë relative. Sipas te dhënave të tregut në vënd numri i dëmeve të paguara vitin e kaluar u rrit me 2,514 raste, duke arritur në rreth 76 mijë dëme.

Të nderuar miq të Atlantik!

Përballë vështirësive të tilla, kompania jonë rriti vëmendjen për klientët. Policat tona të sigurimit, të hartuara me kujdes maksimal

në degët tona mbuluan më shumë se 421 milionë lekë dëme në të gjithë Shqipërinë.

E themeluar 24 vite më parë, ATLANTIK vijoi edhe gjatë vitit 2025 të forcojë ofertën e produkteve për një shërbim më të shpejtë dhe më efikas ndaj klientëve. Investimet në sistemet tona të vlerësimit të rrezikut, automatizimi në trajtimin e kërkesave dhe trajnimi i stafit kanë rritur kohën e përgjigjes dhe cilësinë e shërbimit.

Për më tepër, përkushtimi ynë ndaj menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme ka përforcuar besimin e partnerëve dhe klientëve tanë. Së bashku do të vazhdojmë të ofrojmë siguri dhe besueshmëri edhe për të ardhmen.

Ju falenderoj të gjithëve për bashkëpunimin!

MISIONI DHE VIZIONI

Me 24 vite në tregun shqiptar, ATLANTIK është tashmë një emër kuptimplotë në tregun e sigurimeve. Misioni ynë i përditshëm në këtë çerekshekulli ka qenë një dhe i pandryshueshëm: të ofrojmë siguri dhe besueshmëri për çdo klient që kërkon ndihmën tonë.

Për ne çdo klient konsiderohet një partner. Të gjitha degët e shpërndara në të katër anët e vendit kanë qëllimin e vetëm, për të qëndruar sa më pranë shqetësimit të çdo qytetari që zgjedh të na besojë pronën e tij.

Të mbrojmë njerëzit, familjet dhe bizneset duke ofruar zgjidhje sigurimi të qarta, të aksesueshme dhe të besueshme; të reagojmë shpejt dhe me profesionalizëm kur klienti ka nevojë dhe të përdorim teknologjinë me përgjegjësi për të krijuar një përvojë më të thjeshtë, më transparente dhe më njerëzore.

“Fuqia juaj e sigurimeve” nuk është vetëm një slogan për ne. Ai është puna jonë e përditshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e klientëve.

Vizioni ynë

ATLANTIK synon të jetë një nga kompanitë më të besueshme dhe më të aksesueshme

të sigurimeve Jo-Jetë në Shqipëri, e njohur për shërbim të shpejtë, trajtim transparent të dëmeve, inovacion të dobishëm dhe kontribut të prekshëm në reziliencën e familjeve, bizneseve dhe shoqërisë.

Vizioni i ATLANTIK mbetet rritja e gamës së shërbimeve. Synimi është shtrirja e hapësirës së mbulimit, shkuarja sa më pranë kërkesave të klientëve, zgjerim të paktave të shërbimeve dhe rritje në treg. Përveç 14 degëve, nga veriu në jug, ne synojmë të zgjerojmë shërbimet online.

Ne në ATLANTIK kemi qenë gjithnjë të hapur ndaj zhvillimeve teknologjike. Përveç ofrimit të shërbimeve online synimi është shkuarja drejt përdorimit të Inteligjencës Artificiale edhe në tregun e sigurimeve. Qëllimi është një analizë më e saktë dhe më e detajuar për të mbrojtur asetet e klientëve tanë.

ATLANTIK mbetet i vendosur në vizionin e tij që çdo shërbim të mbështetet nga transparenca dhe kujdesi maksimal për të gjithë klientët.

Faleminderit të gjithëve për besimin që na keni dhënë!





OBJEKTIVAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË BIZNESIT U ORIENTUAN PËR 2025:

- Transformim të thellë të shumë aspekteve strukturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovacionit dixhital.
- Sigurimin e produkteve, shërbimeve me profesionalizmin dhe etikën, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, **kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet.**
- Shërbime të orientuara në kërkesat e klienteve, mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimi tek ai.
- Planifikimi strategjik për rritjen e volumit të të ardhurave, duke synuar rritjen e vazhdueshme të ATLANTIK, struktura fleksible, rritjen e imazhit në publik me qëllim mbrojtjen e individëve, familjeve dhe bizneseve duke ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme
- Monitorimi i vazhdueshëm i situatës dhe zbatimi i planeve për të minimizuar pasojat e pandemisë në aspektin financiar dhe efektet e mundshme, për vazhdimësinë e veprimtarisë së qëndrueshme të biznesit në situatën aktuale.
- Shoqeria bazuar në raportimet dhe treguesit e aftësisë paguese, rruajti treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit dhe stabilitetit financiar.
- Permiresimi i cilesise se punes se punonjesve, nepermjet perzgjedhjes, rekrutimit dhe trainimit te tyre si dhe persosjen e metodes se shperblimit per punen e bere nga gjithsecili.
- Zbatimi i politikave te investimeve te shoqerise me qellim rritjen e vleres se tyre.
- Hedhja ne treg e produkteve nepermjet shitjeve on-line te cilat permbushin nevojat e klienteve, ne kushtet e pandemise dhe distancimit social.



STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQËRISË ATLANTIK SH.A.

Per shkak te historikut te krijimit te saj, Shoqeria ATLANTIK sh.a eshte nje marke tregtare prej 24 vitesh ne tregun e sigurimeve shqiptare. Kompania në mënyrë të vazhdueshme ka forcuar drejtimin në stafin e saj duke zhvilluar një strukturë organizative sa më efeciente, elastike dhe optimale.

Strukturat pergjegjese per realizimin e Këshilli Mbikëqyrës i Shoqerise ATLANTIK **objektivave janë:**


- Këshilli Mbikëqyrës
 - Drejtori i Pergjithshem,
 - Komiteti i Auditimit dhe Administrimit te Riskut
 - Departamentet, Drejtorite dhe sektoret ne Drejtorine e Pergjithshme,
 - Drejtorite Rajonale ne Rrethe
- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Luan BREGASI | Kryetar |
| 2. Envi HICKA | Anëtar |
| 3. Aleksander MUSKAJ | Anëtar |

TREGUESIT KRYESORE TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ATLANTIK 2025


Shoqëria ATLANTIK sha gjate Vitit 2025 ka kryer aktivitetin sigurues në vend duke shenuar një rritje mbi nivelin e tregut të sigurimeve prej 12%, duke ruajtur renditjen në vendin e 8-te. Performanca e kompanisë gjatë vitit 2025 shënoi progres dhe vlerësohet pozitive dhe e qëndrueshme në përmbushjen e detyrimeve në pagesat me demet.

Treguesit kryesor të aktivitetit të shoqërisë ATLANTIK për vitin 2025 sipas publikimeve të AMF-se:


- Të ardhurat nga primet bruto në vitin 2025 kapin vlerën mbi 1,540,791,774 mijë leke, me një rritje prej 12% kundrejt vitit 2024.



- Ecuria sipas linjave kryesore të biznesit për 2025 krahasuar me 2024 për produktet e Jo Jetes ka qenë si më poshtë:



- Viti 2025 rezulton me raport 19% vullnetare dhe 81% te detyruara.



- o Volumi i primeve për sigurime te Detyrueshme për vitin 2025 ka pesuar rritje me 13% në krahasim me 2024.
- o Volumi i primeve për sigurime Vullnetare është rritur në masën 8% kundrejt vitit 2024.

ATLANTIK renditet e pesta në treg për raportin e sigurimeve vullnetare me rreth 19%.

- **Shpërndarja Gjeografike në 2025** e të ardhurave nga Atlantik, rezultojnë si më poshtë:

SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE	PRIME TOTAL 2025	% në Totalin e Primeve Respektive	2025		% në Totalin e Primeve respektive	
			SIGURIMI I DETYRUESHEM	SIGURIMI VULLNETAR	SIGURIMI I DETYRUESHEM	SIGURIMI VULLNETAR
TIRANA	1,031,192,267	67%	830,616,587	200,575,680	66%	71%
DEGET NE RRETHE	509,694,469	33%	427,324,757	82,369,712	34%	29%
TOTAL	1,540,886,736	100%	1,257,941,343	282,945,392	100%	100%

- Rritja e volumit të primeve, të ardhurave nuk ka ndikuar në përkeqësimin e raportit të shpenzimeve. Megjithatë primet e këtij viti kishin rritje për 12% krahasuar me vitin e kaluar raporti i përgjithshëm të ardhura/shpenzime paraqitet i kënaqshëm, ku kjo pasqyrohet dhe në fitimin e realizuar.

RAPORT VJETOR - 12

- Dëmet e paguara për vitin 2025 rezultuan në vlerën prej 421,002 mijë lekë. Në totalin e dëmeve të paguar për vitin 2024, rreth 98% e zene pagesat për dëmet e sigurimeve motorrike dhe 2% e vlerës është pagesa për dëmet e Sigurimit të Pasurisë. Strategjia e shoqërisë në zgjidhjen me negociata e marrëveshje me palët përfituese ka bërë që të bjerë dhe numri i padive në Gjykatë dhe të mbyllen rastet e sigurimit në kohe reale.

Shoqëria Atlantik rezultoi për 2025 me numrin më të vogël të dëmeve pezull në proces në tregun e sigurimeve në vend.

Atlantik është shoqëria siguroese në vend me:

- pagesat më të shpejta të dëmeve dhe
- numrin më të ulët të ceshtjeve në gjykate
- numrin më të ulët të dëmeve pezull në treg:

Në sajë të punës së mirë planifikuese, organizuese e drejtuese, në sajë të masave organizative e efektive, shoqëria Atlantik shpesh është një shoqëri me parametra të stabilizuar, të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.

- **Politika e pranimi dhe menaxhimit të rrezikut** ka ndikuar drejtpërdrejt në identifikimin e fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm.

Menaxhimi i administrimit të rrezikut ka ndikuar në ruajtjen e vlerave në të gjitha proceset e drejtuesve të njësisë, menaxherëve dhe pjesës tjetër të stafit, duke projektuar dhe identifikuar ngjarjet e mundshme që kanë impakt në shoqëri si dhe menaxhuar riskun duke e mbajtur brenda kufijve të oreksit për arritjen e objektivave të shoqërisë ATLANTIK.

Raporti i likuiditetit gjatë gjithë vitit 2025 ka qenë mbi vlerën 100% në përputhje me kërkesat e AMF.

RAPORTI I AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Shoqeria e sigurimeve Atlantik sh.a

*Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas Standarteve Ndërkombëtare të
Raportimit Financiar per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.*



MISIONI DHE FUNKSIONI

Misioni i Auditimit të Brendshëm është të mbështesë arritjen e objektivave strategjike të shoqërisë Atlantik sh.a., duke ofruar siguri të pavarur dhe objektive, si dhe shërbime këshillimore që krijojnë vlerë të shtuar dhe kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të qeverisjes, menaxhimit të rreziqeve dhe kontrollit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm luan një rol të rëndësishëm mbështetës për menaxhimin dhe organet drejtuese, duke ofruar vlerësime të pavarura që ndihmojnë në marrjen e vendimeve të informuara, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve dhe promovimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore, kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), si dhe politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë.

METODOLOGJIA, BAZA LIGJORE DHE PLANI VJETOR

Auditimet e kryera në shoqërinë e sigurimeve Atlantik sh.a. janë realizuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IIA), Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe metodologjinë e miratuar për ushtrimin e funksionit të auditimit.

Gjatë vitit 2025, funksioni i Auditimit të Brendshëm në shoqërinë e sigurimeve Atlantik sh.a. ka zhvilluar veprimtarinë e tij në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2025, të miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 11, datë 27.12.2024. Ky Plan Vjetor i Auditimit është hartuar mbi bazën e një vlerësimi të rreziqeve të veprimtarisë së shoqërisë, duke mundësuar orientimin e burimeve të auditimit drejt proceseve dhe aktiviteteve me ekspozimin më të lartë ndaj rrezikut.

Deklarata e Pavarësisë

Funksioni i Auditimit të Brendshëm në shoqërinë Atlantik sh.a. ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm konfirmon se gjatë vitit ushtrimor 2025 ka gëzuar pavarësi të plotë institucionale dhe profesionale.

Audituesit e Brendshëm nuk kanë qenë të përfshirë në procese operationale apo vendimmarrëse të menaxhimit në fushat e audituara, duke garantuar objektivitetin, paanshmërinë dhe pavarësinë e gjykit profesional gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit.

Punonjësit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm kanë vepruar në përputhje me parimet e integritetit, objektivitetit, konfidencialitetit, kompetencës profesionale dhe etikës, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës për profesionin.

STRUKTURA ORGANIZATIVE, RAPORTIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Për të garantuar objektivitetin dhe pavarësinë e funksionit të Auditimit të Brendshëm, ky funksion mban një linjë të dyfishtë raportimi: raportim funksional tek strukturat e pavarura të mbikëqyrjes dhe raportim administrativ tek menaxhimi i lartë.

Në përputhje me organigramën e Shoqërisë Atlantik, funksioni i Auditimit të Brendshëm raporton në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë tek Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e strukturave të pavarura të mbikëqyrjes, si dhe administrativisht tek Drejtori i Përgjithshëm i Atlantik sh.a.

Me qëllim përshtatjen me zhvillimet teknologjike dhe transformimin dixhital të shoqërisë, stafi i Auditimit të Brendshëm ka ndjekur trajnime të specializuara në fushën e auditimit të sistemeve të informacionit në mënyrë që të forcohen kapacitetet profesionale për vlerësimin e kontrolleve dhe rreziqeve në mjediset teknologjike.



OPINIONI I AUDITUESIT TË BRENDSHËM

Në përfundim të auditimeve të kryera gjatë vitit 2025, bazuar në punën e realizuar dhe provat e mbledhura, jepet një siguri e arsyeshme se korniza e kontrollit të brendshëm, e qeverisjes korporative dhe e menaxhimit të rreziqeve në shoqërinë Atlantik sh.a. është e mirëstrukturuar, funksionale dhe mbështet në mënyrë efektive arritjen e objektivave të saj.

Pjesa më e madhe e proceseve të audituara janë vlerësuar me nivelin “kënaqshëm”, ndërsa për proceset e vlerësuara me “ka nevojë për përmirësim” janë përcaktuar rekomandimet përkatëse, së bashku me afatet e zbatimit.

Gjatë vitit 2025 nuk janë konstatuar mangësi kritike, anomali materiale apo rreziqe të jashtëzakonshme që mund të cenojnë stabilitetin financiar, vazhdimësinë e aktivitetit apo reputacionin e shoqërisë.

Permbledhje: Strukturat e qeverisjes së Atlantik sh.a. ofrojnë një bazë të qëndrueshme dhe efektive për arritjen e objektivave strategjike, menaxhimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e interesave të aksionerit dhe klientëve të Shoqërisë

Objektivat strategjike për vitin 2025:

- ✓ Forcimi i kuadrit të administrimit të rreziqeve;
- ✓ Forcimi sigurise kibernetike;
- ✓ Përmirësimi i raportit të produkteve vullnetare;
- ✓ Pagesa e shpejtë e dëmeve;
- ✓ Arritja e një pozicioni të qëndrueshëm në tregun e sigurimeve.
- ✓ Përmirësimi i imazhit dhe standarteve.
- ✓ Raportimi pasqyrave financiare sipas standartit të ri IFRS17.

ATLANTIK





RSM ALBANIA
Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.


Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë për veç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.



- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin numër 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të Aftësisë Paguese dhe Aktivit për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor
RSM Albania
Tiranë, 27 prill 2025



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	7	56,265,356	30,875,031
Depozita me afat me bankat	8	1,325,680,519	1,026,864,252
Të arkëtueshme nga kontrata e sigurimit	9	227,056,143	160,871,430
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	10	305,724,532	266,079,004
Aktive të risigurimit	11	44,934,349	10,222,472
Investime në pasuri të paluajtshme	12	356,197,813	368,206,697
Aktive afatgjata materiale	13	161,184,001	153,918,112
Aktive afatgjata jo-materiale	14	5,575,400	6,156,140
E drejta e përdorimit të aseteve	15	93,918,806	105,102,248
Parapagime ndaj paleve të lidhura	16	106,904,980	157,692,232
Aktive të tjera	17	260,775,282	281,297,627
Totali i Aktiveve		2,944,217,181	2,567,285,245
DETYRIMET			
Detyrime për humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	491,143,376	298,581,656
Rezerva për primet e pafituara	19	1,046,029,453	904,543,960
Detyrime ndaj risiguruesit	20	12,031,705	11,932,384
Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera	21	52,250,564	37,508,374
Detyrime nga kontratat e qirasë	22	96,586,130	113,574,058
Detyrime tatimore	23	6,605,844	6,610,437
Provizione të tjera në lidhje me sigurimet	24	38,000,000	38,000,000
Rezerva për fond kompensimi	25	45,339,537	48,565,430
Totali i detyrimeve		1,787,986,609	1,459,316,299
KAPITALI			
Kapitali themeltar	26	827,469,281	827,469,281
Rezerva të rrezikut të pasiguar	27	17,787,665	17,787,665
Fitim/ humbjet e mbartura		162,712,000	112,128,611
Fitimi i vitit		148,261,626	150,583,389
Totali i kapitalit		1,156,230,572	1,107,968,946
Totali detyrimeve dhe kapitalit		2,944,217,181	2,567,285,245

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Prime të shkruara bruto	28	1,540,828,184	1,379,073,431
Ndryshimi neto në rezervën për primet e pafituara		(141,485,493)	(85,703,534)
Të ardhurat bruto nga primi i sigurimit		1,399,342,691	1,293,369,897
Prime të ceduara risiguruesit	29	(36,612,995)	(33,439,980)
Pjesa e risiguruesve në ndryshim në provizionin për primin e pafituar		843,248	(857,559)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		1,363,572,944	1,259,072,358
Të ardhura të tjera	30	23,222,407	21,722,570
Të ardhura neto		1,386,795,351	1,280,794,928
Humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes		(613,340,093)	(400,916,477)
Demet e ceduara ne risigurime		33,868,629	-
Dëmet neto të sigurimit		(579,471,464)	(400,916,477)
Kostot e marrjes ne sigurim	31	(311,387,022)	(314,676,637)
Shpenzime administrative	32	(283,499,779)	(286,055,220)
Shpenzime të tjera sigurimi	33	(36,361,000)	(93,601,184)
Fitimi (humbja) operative		176,076,086	185,545,410
Të ardhura financiare, neto	34	18,654,714	10,375,012
Humbje nga kursi i kembimit, neto	35	(4,269,655)	(9,084,984)
Të ardhurat/(shpenzimet) financiare neto		14,385,059	1,290,028
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat		190,461,145	188,626,053
Tatimi mbi fitimin	36	(42,199,519)	(38,042,664)
Fitimi (humbja) për vitin		148,261,626	150,583,389
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin		148,261,626	150,583,389

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse ekëtyre pasqyrave financiare.

Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a.

(Të gjitha shumatat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali themeltar	Rezerva	Fitime / (humbje) e mbartur	Fitim/ humbje e vitit	Totali
Gjendja më 1 janar 2024	827,469,281	17,787,665	55,518,756	106,609,855	1,007,385,557
Fitim i vitit	-	-	-	150,583,389	150,583,389
Dividend	-	-	(50,000,000)	-	(50,000,000)
Transferimi ne fitime te mbartura	-	-	106,609,855	(106,609,855)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	827,469,281	17,787,665	112,128,611	150,583,389	1,107,968,946
Fitim i vitit	-	-	-	148,261,626	148,261,626
Dividend	-	-	(100,000,000)	-	(100,000,000)
Transferimi ne fitime te mbartura	-	-	150,583,389	(150,583,389)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	827,469,281	17,787,665	162,712,000	148,261,626	1,156,230,572

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 10 prill 2026, dhe janë firmosur në emër të tij nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori Departamentit të financës:



Dritan Çelaj

Drejtori i Përgjithshëm

Juljana Kupi

Drejtore Departamentit të Financës

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		190,461,146	188,626,053
Regullime për;			
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afat-gjata	13,14,15	57,093,092	51,207,597
Të ardhura nga interesi		(25,046,377)	(17,320,124)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative		222,507,861	222,513,526
<i>Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative</i>			
Ndryshimi në llogarite e arketueshme të sigurimit		(66,184,713)	4,041,696
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(39,645,528)	13,924,272
Ndryshimi në aktivet e risigurimit		(34,711,878)	857,559
Ndryshimi në parapagime ndaj palëve të lidhura		50,787,252	(17,339,054)
Ndryshimi në aktive të tjera		20,522,344	(74,434,720)
Ndryshimi në rezervën teknike për dëme		141,485,493	85,703,534
Ndryshimi në rezervën e primit		192,561,719	8,426,835
Ndryshimi në detyrimin nga risiguresi		99,322	223,083
Ndryshimi në detyrimet nga sigurimi dhe të tjera		11,516,296	4,789,383
Interesi i arkëtuar		21,887,945	13,360,405
Flukse monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		520,826,113	262,066,519
Tatimi i paguar mbi fitimin		(42,204,112)	(45,550,995)
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative		478,622,001	216,515,523
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje neto aktive afatgjata		(25,576,961)	(38,120,616)
Rritje në depozitat me afat		(295,657,835)	(110,668,410)
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitete investuese		(321,234,796)	(148,789,026)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Detyrimi i qirase		(31,996,880)	(17,798,523)
Dividente		(100,000,000)	(50,000,000)
Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese		(131,996,880)	(67,798,524)
Rritja neto në mjetet monetare		25,390,325	(72,025)
Mjete monetare në fillim të vitit		30,875,031	30,947,056
Mjete monetare në fund të vitit	7	56,265,356	30,875,031

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Aftësia Paguese

VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	665,509,111
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	249,928,097
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	374,892,146
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	290,616,966
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

Aktiviteti në mbulim të provigjoneve teknike

IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)	1,984,128,868
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")	1,825,158,583
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)	1,537,172,829
VI.1	Provigjone të primit të pafituar	1,046,029,453
VI.2	Provigjone të dëmeve	491,143,376
VI.3	Provigjone për bonuse dhe rabate	
VI.4	Provigjone barazimi dhe katastrofe	
VI.5	Provigjone të tjera teknike	
VII	Tepricë (+) / Mungesë(-) (V-VI)	287,985,754
VIII	Mbulimi në % (V/VI)	118.73%



www.atlantik.al

Drejtoria Qendrore: Rr."Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë, NIPT nr. K11807008V,
Tel./Fax (04) 235088, Tel. (04) 230 506,
Email: info@atlantik.al, www.atlantik.al